

Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”

Fakulteti i Filologjisë

Programi: Letërsi shqipe



POEZIA E MIGJENIT

(Punim diplome)

Mentori

Prof. Kamber Kamberi

Kandidati

Dukagjin Geca

Gjakovë,

2017

MIRËNJOHJE

Që në fillim dua të shpreh falënderimet dhe mirënjohjen time për të gjithë ata që kanë luajtur një rol të rëndësishëm dhe më kanë përkrahur e stimuluar vazhdimisht, në çfarëdo forme qofshin ato gjatë studimeve të mia në Fakultetin e Filologjisë të Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani".

Në radhë të parë, mirënjohje dhe falënderime të sinqerta për familjen time, e cilavazhdimisht ishte pranë meje me përkrahje të gjithanshme, gjatë gjithë kësaj periudhe të rrugëtimit tim si student.

Falënderoj veçanërisht mentorin Prof. Kamber Kamberi, për sugjerimet, mbështetjen dhe përkrahjen e tij të vazhdueshme.

Përgjithmonë mirënjohës!

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	5
Jeta dhe veprimtaria letrare e Migjenit	7
Poezia e Migjenit	9
Kushtet historike-shoqërore në të cilat u krijuan veprat e Migjenit.....	12
Analizë e poezive të Migjenit "Vargje të lira" sipas cikleve.	14
Ndarja e poezive.	15
Figurat poetike te poezia e Migjenit	16
Cikli i "Këngëve të ringjalljes"	18
Cikli i "Këngëve të mjerimit"	21
Cikli i dytë"Këngët e mjerimit"	23
Cikli i "Këngëve të Rinisë"	26
Arti i Migjenit	27
Perfundimi.....	30
AUTOBIOGRAFIA.....	35
LITERATURA	36



MILLOSH GJERGJ NIKOLLA - MIGJENI (1911-1938)

KANGËT E PAKËNDUEME

Thellë në veten teme flejnëkangët e pakëndueme
të cilat ende vuejtja as gëzimi s'i nxori,
të cilat flejnë e presin një ditë ma të lumnueme
me shpërthye, m'ukëndue pa frigë e pa zori.

Thelltë në veten teme kangët e miajesin...
e unë jam vullkani që fle i fashitun,
por kur t'i vijë dita të gjitha ka me i qitun
në një mijë ngjyra të bukra që nuk vdesin.

Por a do të vijë dita kangët me u zgjue?
Apo ndoshta shekujt me ne prap po tallen?
Jo! Jo! Se liria filloi me lulzue
dhe e ndej nga Dielli (alegorik) valën.

O kangët që fleni reliktet e mia
q'ende s'keni prekun as një zemër të huej,
vetëm unë me ju po kënaqem si fëmia
unë- djepi juej; ndoshta vorrijuej.

Hyrje

Milosh Gjergj Nikolla ky është emri, emri i babait dhe mbiemri i tij i vërtetë, sepse *Migjeni*, është pseudonimi ose emri i tij i që njihet në shkrimet dhe punën e tij. Ishte poet dhe prozator i shquar shqiptar i periudhës së Letërsisë moderne, përkatësisht i viteve '30. Migjeni konsiderohet si një ndër shkrimtarët më të lexuar e më të rëndësishëm të letërsisë shqipe të kësaj periudhe. Për epokën kur jetoi e veproi ishte një zë krejtësisht novator nga brendia dhe forma. Ndikimi i tij në letërsinë shqipe të kohës ishte i madh. Konsiderohet që Migjeni kaloi nga një romantizëm revolucionar në realizëm kritik gjatë jetës së tij. Ai pasqyroi varfërinë e thellë të viteve kur jetoi, dhe duke u dalë zot heronjve të krijimeve të tij si "Bukën tonë të përditshme falna sot", "Bukuria që vret", "Mollë e ndalueme", "Legjenda e misrit", "A don qymyr zotni ?", etj. fshikulloi ashpër indiferentizmin e klasave të kamura ndaj vuajtjeve të popullit. Ndikimi i Migjenit mbi rrethet e rinisë anticifligare që i ndjeshëm në vitet kur shkroi. Një shtysë te posaçme mori përhapja e krijimtarisë së tij pas Luftës së Dytë Botërore, kur regjimi komunist mori përsipër botimin e plotë të veprave, të cilat në vitet 1930 kishin qenë pjesërisht të pabotuara.

Në themel të veprimtarisë së Migjenit qëndron tema sociale e varfërisë, aspirata për një botë të re, ku njerëzit e thjeshtë të jetojnë të lirë dhe të lumtur me dinjitet njerëzor dhe pa frikë për të nesërmen. Ky humanizëm aktiv përshkon gjithë veprën e tij në prozë e poezi. Në poezitë e para, si "Zgjimi", "Të birt' e shekullit të ri", "Shkëndija", "Shpirtënit shtegtarë", etj. pakënaqësia e thellë ndaj realitetit shoqëror dhe ëndrra e autorit për një të ardhme më të mirë u shpreh me figura të gjalla që ndonjëherë shënohet edhe me nota romantike. Kështu poeti u ngrit kundër amullisë shoqërore dhe forcave që mbanin vendin në një gjendje të vështirë ("kalbësinave që kërkojnë shejtnim"). Kritika e rreptë e gjendjes së rëndë të vendit u gërshetua në këto vepra me dëshirën e zjarrtë për "një agim të lum e të drejtë kombëtar", me grishjen për të luftuar për ditë më të mira për të gjithë. Dhe gjithë zhvillimi formues artistik i Migjenit si shkrimtar është karakterizuar me kalimin e tij të shpejtë nga një romantizëm që mund të quhet revolucionar në një realizëm kritik.

Pasqyrimi i varfërisë së thellë të masave shoqërore zë vend qendror në botimet e Migjenit. Për shkrimtarin kishte rëndësi të madhe shoqërore që të dilte në dritë sa më qartë

humnera e vuajtjeve të popullit dhe mesazhi për ndryshimin e kësaj gjendjeje. Heronjtë e veprave të tij më të mira (“*Bukën tonë të përditshme falna sot*”, “*Bukuria që vret*”, “*Mollë e ndalueme*”, “*Legjenda e misrit*”, “*A don qymyr zotni ?*”, etj.) ishin kryesisht të papunë që rropateshin gjithë ditën për të nxjerrë kafshatën e gojës, malësorë që qëndronin në zgrip të jetës, të mjerë që nuk u kishte ecur fati dhe kujdesi shoqëror në jetë dhe ishin flakur jashtë shoqërisë. Në “*Poemën e mjerimit*”, veprën e tij më të shquar, Migjeni përshkroi në tablo të gjallë dhe rrëqethëse të gëlltitjes së vështirë të masave të shtypura dhe të shfrytëzuara, të venitjes së tyre fizike nën grushtin e mjerimit. Në një varg shkrimesh, si “*Zoti të dhashtë*” etj., Migjeni fshikulloi ashpër indiferentizmin e klasave të kamura ndaj vuajtjeve që hiqte populli në përgjithësi. Shtresat e privilegjuara, Migjeni i pasqyroi kryesisht në jetën e tyre vetjake. Ai, tregoi moralin hipokrit dhe despotizmin që karakterizonte marrëdhëniet e tyre familjare (“*Të çelen arkapijat*”, “*Studenti në shtëpi*”). Në tregimin “*Studenti në shtëpi*” vuri në lojë inteligjencien borgjeze, si forcë e paaftë për të luftuar të keqën dhe përpjekjen për ideale të larta. Ai, goditi haptazi dhe me forcë artin dhe shtypin zyrtar (“*Kanga skandaloze*”, “*Programi i një reviste*”, “*Novelë mbi krizën*” etj.) Skamorët, të cilët i urrenin shtypësit, por ende nuk guxonin dhe nuk kishin forcë të ngriheshin kundër tyre, Migjeni i trajtoi dhe pasqyroi me simpati të thellë. Në skicat “*Luli i vocërr*” dhe sidomos të “*Zeneli*”, shkrimtari vuri në dukje aftësitë intelektuale të masave dhe dëshirën e zjarrtë për ndryshime në gjendjen e tyre shoqërore. Ai, tregoi edhe shfaqjet, sado të zbehta të protestës së tyre ndaj padrejtësisë shoqërore (“*Mollë e ndalueme*”). Me rrëfimin e thjeshtë dhe konciz, imtësitë, që zbulojnë thelbin e dukurisë, fryma polemike, psikologjizmi i hollë, filozofia dhe prirja për t’i dhënë personazhet me disa vijëzime, figurat poetike shprehëse, ironia, satira, alegoria etj., këto janë veçoritë kryesore të stilit të Migjenit. Kështu me këtë paraqitje të një stili të veçantë në shkrimet e tij, la gjurmë të dukshme dhe pati ndikim në letrarët e rinj të kohës.

Sidoqoftë edhe pse vdiq në një moshë të re dhe realisht nuk mund të ishte më e gjerë, vepra e tij mbetet një krijimtari artistike me vlera të çmuara ideore-artistike. Një stil i veçantë që bëri thyerje të shablloneve të ngurta të traditës dhe solli diçka të re në letërsinë moderne shqipe. Vepra e tij mbetet kurdoherë objekt i interesimit dhe temë e trajtimeve për studime nga këndvështrime të shumanshme.

Jeta dhe veprimtaria letrare e Migjenit

Migjeni u lind në Shkodër me 30 shtator 1911. Na vie nga një familje e mesme qytetare. Me prejardhje ishte nga Dibra. Babai i tij ishte një tregtar i cili mbante një pijetore sa për mbijetesë. Grushtin e rëndë që shpesh mund ta fal jeta, Migjeni e përjetoi që në fëmijërinë e hershme. Në moshën pesë vjeçare i vdes e ëma, e në moshën trembëdhjetë vjeçare e lë edhe babai! Kujdesin për të e merr motra Ollga ngase edhe i vetmi vëlla i vdiq njëzetë e katër vjeç.

Mësimet e para Migjeni i bëri në shkollën fillore në gjuhën serbe qëgjendej në atë kohë në Shkodër 1919-1933. Një shkollëgjysmë të mesme e mbaroi në Tivar me 1924-1927. Atje kishte të martuar motrën Ollga. Ungji i tij duke e nuhatur talentin e tij dhe etjen për zënien e njohurive e në pa mundësi për të investuar në një shkollë diku jashtë atdheut e regjistroi në një seminar ortodoks që gjendej në Manastir të Maqedonisë. Migjeni këtë seminar e ndoqi pa vullnetin e tij, këtë e hetojmë tek notat e veta në lëndët fetare dhe se mbas mbarimit tëkëtij seminari ai kurrë nuk e ushtroi profesionin e priftit. Ai, kishte pasion për të lexuar veprat e klasikëve të mëdhenj rus, sidomos Pushkinit, Dostojevskit dhe Tolstojit. Lexonte pa pushuar Gorkin dhe Majakovskin. Rusishtja e mësuar në seminar ia mundësoi leximin e këtyre veprave në origjinal.

Me të mbaruar seminarin qarqet e atëhershme kishtarë ortodokse vendosën të ofronin edhe bursë për studime të larta jashtë atdheut, por ai këtë gjë e refuzoi. Shpresonte tek një bursë shtetërore për studimin e letërsisë jashtë Shqipërisë. Një dëshirë e tillëkurrë nuk u realizua! Shkaqet ndër më tëndryshmet: shëndeti ,propaganda e klerikëve ortodoksë shkodran, gjendja e keqe ekonomike etj. Në kohën e këtij djaloshi të ri përplaseshin në mes veti dogma fetare, mësimi i tij i përditshëm në formim e sipër dhe literatura sociale e zgjedhur vullnetshëm nga mësimi i ri. Para tij rrinin njëkohësisht dy shtigje, të vriste petkun e priftit e ti predikonte njohuritë e mësuara mbi fenë, e të përfundonte shtegun në lutje... apo të marr diellin ndër duar dhe të shpërndaj rreze ndër kasollet e malësoreve aq të nevojshme sa dhe dritat e syve.

Mësuesi i ri s'u hamend dhe u nis drejtëVrakës dhe Pukës në misionin e tij të shenjtë, mësues me përkushtimin më të madh.¹ Shtegu i zënë ishte sa i mirë aq edhe i vështirë, për këtë gjë ishte

¹Migjenin e preokuponte shumë si përgatiteshin nxënësit në shkollë. Sa prekej kur i flisja për mungesat, sa shqetësohej për fatin e nxënësve të varfër, të dalë nga gjiri i popullit! Dhe çfarë zemërimi e kapte kur i tregoja sa të zbrazur ishin tekstet, sa punë të keqe bënin disa pedagogë prapanikë! Dhe ai i aprovonte këto dhe vuante. Nuk ishte

tërësisht i vetëdijshëm. Ai nuk ishte i kënaqur me atë çfarë kishte zënë jashtëmësimeve të seminarit, synonte edhe më shumë, vazhdimin e studimeve në fushën e letërsisë.

U nis drejt Torinos, sa për t'u shëruar aq me shpresë për të zgjeruar horizontet krijuese dhe përmbushur projektet e synuara letrare. Ideali tek ky mësues i ri rrinte përpara vlerës së vetë jetës. Vdiq në një senatorium afër Torinos me 26 gusht 1938. Vdekja e tij në këtë shteg është pothuaj tërësisht në emër të atij ideali. Me të vdiqën shumë dëshira e bashkë me to edhe ajo e studimit të letërsisë.

Vepra e Migjenit "*Vargjet e lira*" të cilën e njohim sot, duket se është e tëra ajo që e la Migjeni të botuar dhe të pabotuar. Fati i veprës së tij i ngjasonte pothuajse fatit letrar të poetit, Botimi i parë 1936 u ndal menjëherë pas botimit. Botimin e dytë të vitit 1944 menjëherë në cep të përfundimit të luftës së dytëedhe pse nuk ishtenë tërësi si përmbushje artistike, u përhap në duart e lexuesve dhe pati një jehonë te lexuesi shqiptar. Tek në vitin 1957,Skender Luarasi botoi pothuaj të gjitha shkrimet e këtij autori që njiheshit deri në atë kohë, me titull, Migjeni "*Vepra*". Tok me prozat dhe poezitë autori iabashkëngjiti veprës edhe një biografi të shkurtër dhe një analizë të shkrimeve të tij në prozë dhe poezi.²

e rastit që disa nga këta konviktore, që kishin zënë dorë me Migjenin, i kishin dëgjuar këshillat e tij: EminDuraku, Hajdar Dushi, NazmiRrushiti, Bardhok Biba, e sa e sa të tjerë, bënë edhe jetën fli për një atdhe të lumtur shqiptar... Skënder Luarasi, Ana e panjohur e Migjenit, *Arkiva mediatike shqiptare*,

²<https://sq.wikipedia.org/wiki/Migjeni>

Poezia e Migjenit

Krijimtaria poetike e Migjenit u zhvillua kryesisht brenda tri viteve 1932-1935. Në këto krijime Migjeni **shprehu pakënaqësitë e tij** rreth realitetit shoqëror të asaj kohe përmes të cilave dha pamje tronditëse, të klasave të shtypura dhe të shfrytëzuara. Shfaqti idetë e tij për një shoqëri krejtësisht ndryshe, shoqëri me të drejta të përgjithshme e të barabarta, pa shfrytëzimin e skajshëm të njerëzve dhe luftën e mjerimit. Ai ipërkrahte të rinjtë me idenë përparimtare për të ndryshuar vendin. Vepra e tij i motivonte, i nxiste të merrnin guximin për të vepruar. Por siç e dimë tema kryesore që zotëron në veprën e Migjenit është *mjerimi*. Mjerimi, është përshkruar dhe paraqitur në mënyrën më realiste tëshfaqjes së mundshme. Duke shfryrë dhimbjen që jep mjerimi, autori përshkruan figura, njerëz dhe ngjarje tëmbërthyer që paraqesin tablo të një trishtimi të thellë. Kështu, Migjenin e indinjonte së tepërmi hendeku i thelle i pabarazisë midis klasave. Me anë të figurave artistike, kryesisht hiperbolave dhe groteskut, Migjeni përshkruan përfaqësuesit e klasave të pasura dhe shfrytëzuese. Ai, mjerimin dhe skamjen, nuk e sheh në anën sipërfaqësore, po e shikon në të gjitha aspektet, në atë fizik, shpirtëror, moral e shoqëror. Karakteristikë e poezive të Migjenit është edhe përdorimi i figurave tjera stilistike si: metaforave, epiteteve, ironisë, antitezave, hiperbolës etj.³

Poezia e Migjenit, një poezi novatore, u bëshprehëse e fuqishme e pakënaqësisë ndaj realitetit, e urrejtjes ndaj dhunës dhe shfrytëzimit, ndaj mashtrimit politik, shoqëror dhe hipokrizisë. Duke shpërthyer drejtpërdrejt nga jeta e gjallë, ajo pasqyroi botën shqiptare në vitet '30 me protestat, dhembjet, vuajtjet, ëndrrat dhe shpresat për një të ardhme më të mirë.

Vëllimin e tij "*Vargjet e lira*" (1936) Migjeni e hapte me vjershën "*Parathenia e parathenieve*" ku shpërthentegëzimi i tij se shekulli ka nisur të çlirohet prej skllavërisë shpirtërore. Lajtmotivi i kësaj vjershe e cila është një sinteze e mendimit përparimtar të Migjenit, është shprehur me vargun:

³<http://www.12vite.com/vargjet-e-lira-migjeni/>

"Përditëprendojne Zotat", Njeriu po hipen ne majen e fronit, po bëhet zot i jetës, i tokës se tij, i vetvetes dhe nuk do t'u perulet mes "idhujve". Pas kësaj, vjershat e veta Migjeni i ndanë ne gjashtë cikle:

"Kangët e ringjalljes", "Kangët e mjerimit", "Kangët e përndimit", "Kangë në vete", "Kangët e rinisë" dhe "Kangët e fundit".

Ne ciklin e parë bëjnë pjesë pesë nga vjershat me te mira te Migjenit. Filli qe i bashkon këto vepra, është gëzimi për lindjen e *"Njeriut të Ri"*, prej atyre te varfërve te rritur ne mjerim, të cilët janë ngritur në luftëra të reja, qe të mos humbin me nëlojën e përgjaktë të historisë, të mos jenë mëskllëvër të titanëve tëtërbuar, por zot të vetes e të një botë të re, ku njeriu të jetë i lirë dhe askush të mos e shkele personalitetin e tij.

Këto luftëra nuk janë grabitqare e as për të siguruar privilegje të reja, si ato të hershmet, por janë luftëra të reja, për ndryshime të reja siç i quan poeti me vargun e tij kryengritës. Në këtë cikël kemi edhe protestën ndaj gjendjes së rëndë tëshoqërisë shqiptare, ndaj gjithë forcave konservatore, që e mbajnë atë gjendje në vend, dhe shpërthimin e entuziazmit për lindjen e *"Njeriut"*, i cili do ta drejtoje kombin drejt një agimi të ri.

Në këtë cikël, jeton edhe ideja se vetëm në liri mund tëshpërthejnëenergjitë dhe aftësitë njerëzore. Në gjithë ndryshimet, përmbysjen e botës së vjetër dhe krijimin e botës së re, poeti njeh si protagonistërininë. Ajo është më e pastra, më e bukura pjesë e shoqërisë, ku ai ka shpresat, besimin për fitoret e ardhme, për triumfin e idealit për një jetë te re:

Rini, thuejakanges ma te bukur qe di!

Thuejakanges sate, qe te vlon ne gji.

Nxirre gezimintand, te shpertheje me vrull.

Mos e freno këngën!

Le të marri udhë. (Kanga e rinisë)

Prandaj, poeti është i bindur se asgjë s'mund ta pengojë mëlulëzimin e lirisë, ku do të shpërthejëhovichëm gjithë ato këngë, që ende i flenë në shpirt. Kjo është intuita e poetit, i cili ka aftësinë ta ndjejë i pari rrezën e ngrohtë të Diellit, të jetës së re:

Por a do të vijë dita kanget me u zgjue

Apo ndoshta shekujt me ne prapë po tallen

Jo, Jo! Se liria filloi me lulzue

Dhe e ndjej nga Dielli (alegorik) valen.

Për identifikimin e figurës *Dielli*, ka pasur disa përpjekje për ta zbërthyer e konkretizuar në forma të ndryshme. Por ato vetëm se e kanë vulgarizuar e tjetërsuar perceptimin poetik e filozofik të poetit. Mjafton të mbetemi në simbolikën e tij, në shprehjen e tij dhe ajo thotë gjithçka në mënyrë figurative.

Ai, ia ndien rrezatimin botës së re, shoqërisë së re, e cila do të jetë e ngrohtë dhe e ndritshme, si dielli dhe si ai do të mund të gjallëroja, të zgjojë të rilindë gjithçka që qëndron ende e ndrojtur, e përgjumur e në errësirë. Thirrja, që Migjeni i drejtonte rinisë, në këtë vjershë ishte kuptimplote, optimiste dhe tepër e ngrohtë, intime dhe njëkohësisht edhe romantike:

Thueja, kanges, Rini! Thuejakangesgezimplote!

Qeshu Rini! Qeshu! Bota është'e jote!

Kushtet historike-shoqërore në të cilat u krijuan veprat e Migjenit

Vitet tridhjetë në Shqipëri ishin vite përplasjesh dhe ngulfatjesh, aromë lufte nga jashtë, skamje, shtypje, poshtërim dhe degradim njerëzor. Megjithatë "Dielli alegorik" i Migjenit kishte zënë të lëshojë rrezet e para edhe në Shqipëri. Migjeni këtë e ndjente, se mbante brenda botës së vet, e nxirrte jashtëi'apëshpëriste vetvetes, ia thoshte të tjerëve, shokëve të tij iu thoshte shpesh: *Duhet zgjuar, duhet përmbysur, "zotërat". Duhet treguar popullit rrugën e vërtetë të shpëtimit dhe çlirimit.* Një shok i tij bashkëkohës kujton kur Migjeni shprehej: *"Zogu dhe klika e tij janë armiqtë më tëmëdhenj të popullit shqiptar"*! Për të arritur këtë duhet goditur aleatët e tij të brendshëm në mesin e të cilëve edhe klerin jo parimor, feudalët dhe borgjezët shfrytëzues.

Një botëkuptim të tillë për situatën politike në Shqipëri për armiqtë e jashtëm borgjezia dhe fryma e fashizmit si një e keqe gjithëpërfshirëse në hapësira me të gjera dhe rreth nesh si dhe brenda nesh. Migjeni ushpreh bindshëm pa u hamendur që në shkrimet e tij të para dhe në vazhdim. Vetë titulli simbolik *"Vargjet e lira"* na flet për një botë të lirë, kuptim të qartë të poetit; Jo vetëm varg i lirë pa censurë në formë dhe përmbajtje, por edhe varg që fton e përgatit lexuesin për një kryengritje deri në çlirim. Libri nis me poezinë *"Këngët e ringjalljes"* ku poeti lëshon të godasin kambanat e një kryengritje të përgjithshme. Vazhdon me arsyet pse një domosdoshmëri për një kryengritje të përgjithshme me vargjet e ciklit të poezive. *"Këngët e mjerimit"* ku përshkruan guximshëm e pa hezituuar realitetin e hidhur kohor dhe bën me gisht ndaj fajtorëve për këtë gjendje feudale-borgjeze, dhe mbështetësve fanatik të tij, mbetur nga kaluarat anadollake dhe shfaqja të tjerëve të rinj që po e rrezikonin rendin botëror. Këtë revoltë dhe aktakuzë të përgjithshme, Migjeni e vazhdon me ciklin e poezive me radhë. *"Këngët e përdimit"*.⁴

Siç e thekson Profesor Sabri Hamiti:

"Nëse atje ishte besimi i humbur, këtu do të ndërtohet besimi i ri, apo besimi i gjetur. Ndoshta është humbur rasti i fundit, prandaj kaq i fuqishëm dhe ekzaltues rasti i ri: "fe tjetër, fe e çmendur e Përdimit të mrekullueshëm.../I egzaltuemshkël njeriu në delirium të pakuptueshëm."/

⁴ Migjeni, Vargje të lira, 1936, fq.3.

Duke diskutuar për profecinë e jetës së re që lind në perëndim kritika thotë: “*Migjeni nuk asht rreze dielli qi len, por rreze dielli qiprendon. Asht lajmtar i kohës së re, jo fillues i saj. Bir jo i shekullit të ri” por i mbrami bir, rebel, i shekullit të vjetër.*”⁵

Për ta mbyllur librin që do ta reduktojë vetë me ciklin e këngëve shpresëdhënës, “*Këngët e rinisë*”, këtu poeti nga një betejë klithjesh e dhembjesh me vetveten dhe të tjerët na del ngadhënjimtar me që shpresat nuk i humb dhe ato na i var si gjerdan në qafë të rinjve shqiptar, rinisë e cila po lëkundej dhe pritej të rritej. Kështu bukur veç Migjeni arrin ta mbyllë në mënyrën më të bukur të mundshme për kohën këtë libër me krijime në poezi dhe prozë. “*Vargjet e lira*” të Migjenit të cilën censurae kohës nuk e la tëqarkullojë, fillonte me poezinë “*Parathënje e parathënjeve*” e cila na sqaron gjithë botëkuptimin e revolucionit të Migjenit. “*Përditë perëndojnëzotrat*”.

Njeriu i Migjenit, ai i vogli i ndrydhuri dhe i shtrydhuri po zgjohej e vetëdijesohej për rolin e tij në kohë dhe hapësirë “*Idhujt pa krena*” po binin përditë rrethepërqark. Ai, po përplasej me mësimet fituara në kolegjin jezuit mbi jetën dhe rreth saj, mbi botën ide-materie. Nga kjo përplasje del ngadhënjimtar, niset në misionin e tij të shenjtë, luftë me qarqet politike dhe fetare të asaj kohe, që ishin shkaktar dhe burim i të gjitha atyre të zezave që kishin katandisur masat e gjera. Pas ciklit të këtyre këngëve, Migjeni, vazhdon me ciklin e këngëve “*Këngët e Ringjalljes*” me thirrjen: “*jemi, të gjithë, të gjithë "zotrat" titujt e tërbuem duhet përmbysur pa mëshirë*”.⁶

⁵Sabri Hamiti, *Letërsia modern shqipe*, Prishtinë 1998, f. 175.

⁶Migjeni, *Vargjet e lira*, 1936, faqe 4.

Analizë e poezive të Migjenit "Vargje të lira" sipas cikleve.

Në vend të këshillës për një përpjekje të lexuesit dhe studiuesit për tu futur thellë e më thellë në botën e misterit të vargut të Migjenit. Ai këshillon dhe sqaron: ... *Vepra me karakter luftarak dhe praktikisht për kushtet e veçanta tonat duhet me manevru, pra disa herë në mënyrë të maskueshme. Unë s'mund t'ua spjegoi këtyre grupeve . Ata duhet t'i kuptojnë vet. Qarkullimi i veprës sime diktohet nga imperativi i etapës shoqërore që po kalojmë. Për veten time, unë e çmoj veprën time si një kontribut për bashkimin e këtyre rretheve. Në rrafshin, vepra ime konspektivisht do të kryhet.*

“Kam besim se tregimet e mia do t'i verifikojë zhvillimi i mëvonshëm i ngjarjeve”.⁷

Struktura ciklike e veprës me emërtimet e saj, krijon një rend logjik e tematik të poezive. Në secilin cikël del emërtimikëngërpoezinë , që është një emërtim tradicional: *Parathanja e Parathanjeve*, si hyrje, *Kanget e ringjalljes*, *Kanget e mjerimit*, *Kanget e perndimit*, *Kanget e vete*, *Kanget e rinise*, *Kanget e fundit*.

Titulli i veprës, sipas Profesor Hamitit, ka kuptim të dyfishtë: vargje të lira në mënyrën e ndërtimit të tyre, dhe vargje të lira në vështrimin e lirisë tematike. Që në titull del vetëdija e autorit se po krijonte një poezi tjetër nga rrjedha e poezisë së kohës.

Tematika:shkëputja nga trajtat formale e tematike të poezisë shqiptare të kohës. Mungon tematika atdhetare, apo kombëtare. E kaluara preket vetëm si reflektim në aktualen, por jo si temë e veçantë. Temëzotëruese bëhet tema shoqërore e kohës si dhe dhimbjet personale të lidhura me kohën.⁸

⁷Stefi, Andrea, Rreth historisë së besimit të vëllimit, Tiranë, 1995, fq.68-70.

Ndarja e këngëve

- **Kangët e pakëndueme:** Në këtë cikël Migjeni e shikon artin e poezisë si një mundim të thellë psikologjik, dhe realizimin e krijimit një shpërthim të mundshëm. Ai është i vetëdijshëm që poezia e tij do të shfaqë një rebelizëm të përmbajtur: ...e unë jam vullkani që fleifashitun.
- **Kangët e ringjalljes:** Ideja e zgjimit do të hedhë idenë e lindjes së një njeriu të ri, që do të mëkëmbë një Kohë të Re. Ky njeri i ri do të zgjojë ndërgjegjet e fjetura njerëzore për njohjen e vetvetes, të jetës e të lirisë.
- **Kangët e mjerimit:** I gjithë cikli i këngëve të mjerimit, ku bëjnë pjesë shumica e poezive Migjenit (Poema e mjerimit , Balade qytetse, Lagja e varfun, Melodi e keputun) është i ndërtuar me dy lloje shprehjesh poetike: me një shpërthim të revoltës së poetit, që kërkon veprim, dhe me një tërheqje të tij, abstenim. Në këtë cikël futen edhe poezitë rebelimit poetik të Migjenit kundrejt pamjeve të tmerrshme të jetës. Këto janë poezi të kundërshtimit, qoftë kur ai grindet me vetveten, qoftë kur guxon apo tërhiqet. Kudo theksohet dëshira, malli për veprim, por edhe vetëdija për pamundësinë e veprimit.
- **Kangët e Perëndimit:** Në këtë cikël do të ndërtohet besimi i ri apo besimi irigjetur dhe do të tingëllojë fuqishëm dhe ekzaltues rasti i ri fe e çmendur e Perëndimit tëmrekullueshem ku iekzaltuemshklet njeriu në delirium të pakuptueshëm. Kjo është ëndrra e kapërcimit të pengesave, për një liri që gjendet tjetërkund dhe ku dalin vera të reja njerëzore.
- **Kangët e rinisë:** Këto shpërthime shpirtërore marrin trajta të ekzaltatës së pranverës, të nostalgjisë rinore; femra për Migjenin është e paarritshme dhe dashuria për të mbetet e porealizuar. Gruaja është hyjni apo kob? Edhe kjo do të mbetet një alternativë e fundit dhe e pazgjidhur për Migjenin.
- **Kangët e fundit:** Mbahen si poezitë më të fuqishme të Migjenit, të shkruara kur poeti po lëngonte rënde nga sëmundja. Ato nuk janë me shprehje të jetës, por përshkrim i ngadalshëm i vdekjes. Vetë titujt e vjershave: Një natë pa gjumë, Vujejtja, Frymezim' I pafat, Kanga që s'kuptohet, Vetmia, Nën flamujt e melankolisë japin poetikisht shkallët e rënies së poetit.⁹

⁹<http://www.12vite.com/vargjet-e-lira-migjeni/>

Figurat poetike te poezia e Migjenit

Vargjet e lira dhe metafora

Përveç aspektit tematik, konceptit filozofik, moderniteti i poezisë së Migjenit është i dukshëm edhe në rrafshin stilistik. Figura më e privilegjuar e shprehjes poetike te Vargjet e lira është metafora. Dihet se ky trop është i pranishëm në poezinë e mëparshme, prandaj studiuesit e quajnë të udhës të saktësojnë ku qëndron ndryshimi midis përdorimit të metaforës nga poeti modern dhe përdorimit të saj nga poeti tradicional. Metafora nuk është më e izoluar as e ngjitur si një zbulim apo një ilustrim i thjeshtë, ajo përfshihet në një lëvizje për rikrijimin e realitetit sipas ndjeshmërisë sonë, me një rrëshqitje, me një lidhje zinxhir të imazheve në një artikulum muzikal.

Vargu i lirë është karakteristikë e poezisë së këtij autori, i cili tejkalon anën konvencionale të ndërtimit të poezisë duke krijuar një stil të ri. Kjo shihet që nga titulli i përmbledhjes Vargjet e lira. Ndonëse një masë e poemave të Migjenit kanë fakturë klasike, janë shkruar me varg të matur, madje ndonjëherë ai përdor edhe sonetin (*Kanga e rinis, Sonet pranveruer*), por janë të dukshme rastet kur ai e çliron vargun plotësisht nga rregullat e metrikës klasike, siç ndodh te "*Parathania e parathënieve*", te *Vuejtja*, apo *Nën flamujt e melankolisë*.

Ciklet e vjershave të tij, të emëruara kangë, kanë temat dhe idetë që korrespondojnë me vetë emërimet e tyre, p.sh. *Kangët e ringjalljes*, pa dyshim artikulojnë idenë për zgjimin, për lindjen e njeriut të ri, i cili do ta ndryshojë jetën, do ta zgjojë ndërgjegjen e njeriut për ta kuptuar jetën dhe nevojën për liri. Edhe studiues të tjerë të poezisë sonë kanë theksuar se origjinaliteti i Vargjeve të lira qëndron sidomos te përdorimi i metaforës.

Për dendurinë dhe funksionin e metaforës në Poemën e mjerimit ka bërë një analizë të hollësishme poeti Koçi Petriti në studimin e tij Poema e mjerimit – një kuti e Pandorës. Poema e mjerimit u prin poezive të ciklit “*Kangët e mjerimit*” dhe është më e njohura ndër lexuesit.

“*Kangët e mjerimit*” ngërthejnë në vete numrin më të madh të poezive të mjerimit dhe me siguri kjo ka bërë që Migjeni të quhet poet i mjerimit. Në këto poezi, idetë letrare adresojnë shpërthimin e revoltës në një anë, dhe në anën tjetër shpeshherë kemi abstenim ku autori i lë gjërat në rrjedhën e vet sepse koha është ajo që do t'i lëvizë ato në formën e duhur. Migjeni shpalos pamjen e vrazhdët të fryteve që sjell mjerimi me një shprehje të lartë metaforike:

” *Kafshatë që s'kapërdihet asht, or vlla, mjerimi/kafshatë që tëmbetë në fyt e të zë trishtimi /kur shef ftyra të zbeta edhe sy të jeshilta/që të shikojnë si hije dhe shtrijnë duert e mpita /edhe ashtu të shtrime mbrapa teje mbesin/të tanë jeten e vet deri sa të vdesin.*”¹⁰

¹⁰<http://www.bulevardionline.com/millosh-gjergj-nikolla-migjeni/>

Cikli i "Këngëve të ringjalljes"

"Parathënia e parathënjeve" Kënga problematike për regjimin zogist fillonte me vargun gjithësqarues përbotëkuptimin revolucionar të Migjenit " Përditë perëndojnë zotat" dhe rrëshqasin trajtat e tyre." Kjo poezi dhe këto vargje ishin lajm i mirë për ardhjen e një jete të re ku njerzimi nuk do të gënjejë më nga përrallat biblike që ia servonin ushtruesit e predikimeve fetare. Migjeni e kishte humbur besimin tek kjo klasë ! Sikur i dukej që kishin mision për t'i nënshtruar turmat dhe zgjatur jetën sistemit Zogist. Migjeni fillonte dhe e priste njeriun e ri i cili po përgatitej të mos u nënshtrohej "zotrave".

Vjersha shpreh me këmbëngulje botëkuptimin materialist dhe gatishmërinë e tij për një mision në kohë dhe hapësirë më tëshenjhtë luftën shoqërore. Migjeni ndjeu kaosin e momentit në jetën shqiptare më kulturë, ekonomi dhe politikë"*Dhe tash s'po dihet ma kush asht zot e kush njeri...*" Kumbueshëm fillon stina dhe moti i pritur e perëndimit tëzotrave, njeriu gjithnjë e më shumë po qartësohet në vetveten.

Ai u ka shpallur luftë njëherazi zotrave në qiell që s'po ndërmarrin asgjë për t'i shpëtuar njerëzit e tij nga zotat në tokë ! Po i tillë i dukej atdheu, i shitur, andaj i vetmi ishte rebeluar ndaj tëgjithëve.¹¹

Poeti shkante në një përgjithësim edhe më tëmadh duke aluduar si një të mbarë të një revolucioni, si kudo gjithandej botës që e rrethonte. Vjersha shpalle botëkuptimin materialist të një ish seminaristi pa dëshirë të bëhej prift. Mësuesit (priftërinjtë) e seminarit u mbuluan me nxënësin besnik tëBalzakut, Dostojevskit, e të tjerëve që ishin ushqim shpirti dhe dritësimi ndërgjegje për Migjenin.

Pas kësaj poezie që rri pothuaj në gjithë këngët e Migjenit vjen poezia "*Tëbirët e shekullit të ri*". Vitet e tridhjeta Shqipërisë i falen dy taborekundërshtarë: rininë përparimtare që po brumosej me ideologjitë e kohës për popull dhe të ardhmen e tij gjithçka dhe klasën sunduese e çoroditurfundësisht,gjithçka për vete. Këtë atmosferë mbytëse në Shqipëri Migjeni këndon kumbueshëm "*Na t'birët e shekullit te ri, me hovin tonë tëndezun ndër lufta t'reja peshë kemi me u ndeshë. Dhe për fitore kemi me ra fli*".

¹¹Migjeni,Parathënie e parathënjeve, Prishtinë,1977,fq.11.

Këtu në dorë kemi shpirtin delikat e të çiltër të poetit atë shpirtin demokrat dhe revolucionarë. *Liria nuk falet*, thërret poeti ajo fitohet "*ndër lufta t'reja*". Zgjimi i poetit është zgjim gjithkombëtar nuk ngutet vetë brenda për brenda tij. Ideali i poetit është përplasje e sistemit çifligar borgjez deri në asgjësim lufte pa kompromis. Migjeni këtë luftë e pret vetëm kur të ndërgegjësohej e gjithë masa e shtypurpra, ndërgegjësim pararevolucionare. Këtë ndërgegjësim Migjeni e mbështjell vetë me vargun e tij dhe jo veç ai po dhe gjithë brezi krijues.

Noli thërriste "*Dhe një zë vargon nga lumi... ose Biruni, shtypeni...*" pra Migjeni s'ishte vetëm në këtë përballje. Me vete kishte një rini të tërë, ajo po i shtrëngonte grushtet e rezistencës. Migjeni sikur këta, i ndjente, i hetonte, i dëgjonte por i mungonte një lokomotivë, një udhëheqës i dalë nga zemra e ndrydhur e popullit. Këtë gjë e shpreh te poezia "*Të lindet njeriu*". Po ky njeri s'mund të jetë njeriu i Niçes, sepse Migjeni nuk pajtohej me idenë e Mbijes së Niçes, këtë mund ta mësoj lexuesi duke i lexuar vargjet e Migjenit ai është një tjetër njeri. Po si duket ai? nga duhet ardhur ai?

Dhimitër Shuteriqi, thotë: "Migjeni nuk është i qartë kur pret të lindet një njeri që të shpëton popullin, ai e pret gabimisht shpëtimin nga një njeri, nga "heroi" nga "mbinjeriu". "Mbinjeriu" i Migjenit ishte turma ishte opinga, ishte njeriu i dalur nga gjiri i popullit të tij të ndrydhur e të shtypur paftyresisht nga klasa feudale - borgjeze.¹²

¹²Shuteriqi, Dhimitër, Histori e letërsisë shqipe, fq.34.

Rexhep Qosja për Mbinjeriun e Migjenit shprehet "Kjo ide e poetit, marrë në kuptimin e saj të ngushtë çfarë shprehëndaj njeriut revolucionar, njeriu vetëdije e moralit të lartë të pjekur në luftën e kunderthurjeve çfarë shpreson ndaj njeriut të kalibrit, por në kuptimin e gjerë Mbinjeriu i Migjenit është jo individuale por fuqi kolektive e shoqërore.¹³

Poezia "Të lindet njeriu" thotë Mark Gurakuqi është frymëzim reflektiv lidhur me problematikën dhe preokupimet e shoqërisë kombëtare, është frymëzimi reflektiv i brendshëm. Te Migjeni në kërkuesën e tij mund të jetë edhe origjinal njeriu i tij i popullit njeriu i turmës popullore pa yll në ballë. "Vullnete të ndrydhura" "Vullnete të shtypura". Kësaj turme i drejtohet "të shkundin prangat e mbrapshta", të titujve të tërbueme". Besoj këtu Migjeni me këta tituj të tërbueme nuk mendon veç në pushtetin shtypës vendor por edhe të fashistit, italianëve që Zogu na kishte mundësuar ta gërryenin popullin në çdo segment të jetës.¹⁴

Kështu te poezia "Zgjimi" shprehet "Për në theqafje këtej pari ranë edhe vatrat tona në mjerim i për lanë. Nvargun e tij më poshtë tek poezia "Zgjimi" fton në rezistencë duke e kujtuar të kaluarën e lavdishme.

"Me hove viganesh", njëvetëbesim ndoshta i tepruar tek një djalosh i ri dhe jo pa shumë eksperiencë në jetë e as krijimtari. Në moshë aq të re e aq kërkimtar për një popull aq të vogël e të rrethuar me aq shumë armiq. Ku rritej gjithë aj optimizëm i Migjenit për çlirimin e vendit të tij nga këta dy armiq si pushteti vendor dhe fashizmi.

¹³Qosja, Rexhep, Migjeni dhe poezia e tij, Dialogje me shkrimtarë, Prishtinë, 1972, fq. 52.

¹⁴Gurakuqi, Mark, Rreth kritikës mbi veprën e Migjenit, Tiranë, 1961.

Cikli i “Këngëve të mjerimit”

Ringjallja ështëshfaqur në horizont, ndërsa Shqipëria është fundosur këmbë e kokë në mjerim. Prandaj, Migjeni shprehet: e ne si poet kemi detyrë të shenjtë zbulimin e këtij mjerimi para botës. Le ta dëgjojë bota klithmën e turmës së gjerë popullore shqiptare që vije nga kjo mortajëmbjellur nga jashtë e brenda. Migjeni shprehej: ne na duhen shkrimtarë qëdinë ta pasqyrojnë realitetin që jetojmë, që e shohim jetën pa perde pa tensione. (tymë në kishë për luksin) pa frikë.¹⁵ Migjeni e ka fare të qartë misionin e poezisë dhe se pak kush në kohë dhe hapësirë e mbaroi me talent këtë mision. Se Migjeni s'pajtohej me shumë poet të kohës së tij për mos koherim në kohë flasin dje vargjet në poezinë "Motivet" . Ndër fytyra të zbehta të grave tëmjerueme që endeshin pragje tu u shitur lypnin. Ndër fytyra u shkarravitet një vjershë e përmallume. Me vaj me ankime që deri në qiell hipnin. Është hapur kundër tëgjithëve atyre poetëve që për gjendjen mjeruese të femrës derdhi lot "Migjeni". " Mjerimi s'do mëshirë" do vetëm të drejta.

Optimizmi i Migjenit do studiuar pak me më shumë kujdes sepse duhet përgjigjur ku e ka bazën ky optimizëm. *"Jo, jo se liria filloi me lulzue, dhe e ndjej nga dielli alegorik valen"*. Përgjigjen do ta gjejm për informimin e Migjenit për dy lëvizjet botërore, njëra nga këto edhe komunizmi që burimin e kishte në Bashkimin Sovjetik. Ai kishte informata të shumta dhe nga literatura letrare dhe ajo propagandistike. Bashkimi Sovjetik se Dielli i popujve të shtypur lind në lindje. Atje duhet mbajtur syt dhe zemrën, rrezet e atij dielli ishte i bindur se duhet ngrohur edhe këtë popull të vogël në Ballkan.

A ishte Migjeni një shkëndijë në këtë natë të errët shqiptare e shohim tek poezia "Shkëndija". Poezia e tij vërtet ngjante në një shkëndijë ajo lexohet hapur e fshehur ajo përhapej dorë në dorë dhe ishte një shkëndijë shpresë dhënëse se vërtetësiç shprehet ai *"te qielli arbnorë" kah populli i kishte drejtuar syt dhe po mbytej në shpresë... .. e na gezohna, gezohna, dhe puthim agimesh... - q'ashtu rrëfejmë gëzimin.*

¹⁵Shuteriqi, Dhimitër, Histori e letërsisë shqipe,1948.

Migjenin e mbushur me shpresë për një agim të ri e gjejmë këmbë e krye tek poezia e tij emblematike "*Kënga e rinisë*".

Thueja, kangës, Rini! Thuejakangës gëzimplote!

Qeshu Rini! Qeshu! Bota asht'e jote!

Këto vargje kur do të lexohen në retrospektivë tingëllojnë si profetike. Rini, ishte ajo që duhej zënë në dorë çdo punë të jetës shqiptare. Tek ajo poeti varte pushkën e lopatën shpresën e së ardhmes, lirinë dhe barazinë njerëzore për të gjithë këtë popull sa të vuajtur aq krenar. Rini qeshu, Bota është e jote. Ai e fton rininë në një revolucion për të zbardhur dita e qeshjes pa frikë e pa zor. Migjeni i besonte fatin e atdheut vetëm njeriut që po lindej në Shqipëri. Kjo gjë formohet edhe tek poezia brilante e Migjenit "*Këngët e Ringjalljes*". Tek këto poezi Migjeni edhe beson edhe mbush me shpresë dhe sqaron në objektivin e përgatitur duke i njohur dhe pritur sakrificat por "*qielli arbnorë*" ajo do të dritësohet ajo do tëkuqësohet patjetër me rreze lirie.

Cikli i dytë “Këngët e mjerimit”

"Këngët e mjerimit" fillon me poezinë mbi poezitë "Poema e Mjerimit", kryeveprën e Migjenit. Askush në këtë kohë kur Shqipëria ishte katandisur në skamje, mjerim, shkatërrim ekonomik e kulturor nuk i'a vuri dorën popullit shqiptar aty ku i ka plagët dhe ku i la dhembjet, aty ku i ka fyerjet, ku i ka ëndrrat se Migjeni biri i tij besnik e poet. *"Kafshat që s'kapërdihet asht or vlla mjerimi"*. Anija e turmës së gjerë popullore ishte në prag të fundosjes ajo po luftonte për të qenë apo mos qenë ajo po fundosej. "Mjerimi të qon në dorë të hasmit (thotë populli). Ku po ngelej krenaria shqiptareme të cilën e frymonte jetën shqiptari. E Migjeni godet me akuza të rënda kundër klasës sunduese dhe jo vetëm kundër asaj por edhe faltoreve, kishave dhe xhamijave të cilat sikur bënin sehire. *E mbi ta n'ajr therin qiellin kryqat e minaret e ngurta* si me qesëndiprofetët e shenjtorët në fushqeta të shumëngurta për të vazhduar si uragan goditjen e pamëshirshme. *"Një qen i pamëshirshëm me bark shekullor, gjithmonë i pa ngjishëm"*. Këtë klasë sunduese jo vetëm në jetën shqiptare por edhe më gjerë Migjeni e quan qen të pamëshirshëm. *"Mjerimi nuk ka fat ka vetëm zhele. Zhele fund e maje, flamuj të një shprese"*.

Kundruall kësaj klase qenësh të pa mëshirshëm, Migjeni shpreh një klasë të mjerueshme, të pafat, të fundosur në zhele në të cilën klasë mbështet edhe shpresën e shpëtimit. Aty vërtet një ditë me flamur të lirisë do të ngjiten maleve për liri. Profecia e Migjenit do të bëhet realitet pak vite më vonë se kur revoltohet skajshmërisht *"zhele, fund e maje"*. Me këtë poemë Migjeni herë pasqyron gjendjen e pastaj godet pa mëshirshëm. " Migjeni s'do mëshirë por do vetëm të drejta". Migjeni ngritët guximshëm kundër këtij realiteti të hidhur ku drejtohet të mallkoj zot e drejt, mallkon barrën e rëndë ngase fëmijët po i lindin e kafshata po u mungonte. Migjeni është i qartë në kërkesat e tij, ai nuk kërkonte mëshirë po vetëm të drejtë. Mjerimi sipas poetit është njollë që vështirë shlyhet. *"Mjerimi është njollë e pashlyeshme në ballët'njerzimit që kalon nëpër shekuj"*. Tema në poemën e famshme të Migjenit *"Poema e Mjerimit"* nuk është harruar. Ja portreti i tij fizik e shpirtëror: *"Mjerimi rrite fëmijë para se tëburrëroheshin"*. Atë e shohim duke shtrirë dorën për një kafshatë bukë për veten dhe familjen.

Ai është fëmijë pa fëmijën klith në vargjet e mësipërme poeti. Migjeni përveç "*Poemës së mjerimit*" mjerimin si plagë shoqërore të kohës e pasqyruan me totalitetin e notave reale dhe në poezitë "*Laxha e varfun*" dhe "*Recitali i Malsorit*" "Krahtë e zez tej nate pa fund e varrosen laxhen pranë dritë, jetë, gjallëri askund vetëm errësirë e skamje. Njëkasollë, një lagje, një Shqipëri e fundosur në pellgun e mjerimit dhe të varfrit por jo edhe të pashpresë. Dëshpërimi i poetit për këtë gjendje nuk është as dëshpërim i Shopenhauverit e as Fedri Niçessiçmendojnë disa studiues pa të drejtë po është njëdëshpërim momental, apo kohor i poetit, jo i bartur sepse kah fundi i kësaj poezie takojmë një gjel dhe një zë të tij që thërret për zgjim pa vonesë. Dëshpërimi ia lëshon vendin shpresës për një agim të ri në të cilin poeti besonte e shpresonte.

Tek "*Recitali i Malsorit*" kjo shpresë e ky zgjim shihet i shndërruar në një revoltë dhe në njëgatishmëri për revolucion. Malësori i tij klithë pas këtij zgjimi "*oh si nuk e kam një grusht të fuqishëm për ta goditur malin që s'banza*", pushtetin e asaj kohe. Ky malësor është ai malësori kryengritës që turmës popullore do t'i sjellë lirinë. Poeti shihet kudo nëpër vargjet e tij se besonte në zgjimin e shpejtëgjithëpopullor në Shqipërinë e tij që e donte me shumë se vetveten e tij. Ai po luftonte panjohur e veç e veç me dy armiq që shpesh e paraqesin nëdëshpërim çasti. Ishte varfëria, mjerimi, sëmundja e tij që po ja keqësonte gjendjen. Këtë shqetësim për sëmundjen e vrejme sidomos tek cikli i këngëve "*Këngët e pakëndueme*" kur ai bukur dëshpërueshëm "*këndon*". *Thellë në vetën time flejnë këngët e pa këndume, të cilat as vujtja as mjerimi si nxori, të cilat flejnë e presin një ditë më tëlumturume/.*

Në poezinë "*Motivet*" Migjeni sqarohet me vetveten dhe poetët pasivë që po mbillnin pritje pa fund dhe mëshirë ku t'gjenin frymëzimet dhe si ato t'i përcillnin tek lexuesi jo me zburime romantike po me nuanca të theksuara realiste. Ai shkruan "shëtisni" ndër kujtimet e fëmijërisëvergjine, apo të djalërisëvullnduese" por dobi nëse kërkonin frymëzim shikonin papushuar, "*ndër fytyrat e zbehta të grave t'mjerueme*" ... nëpër skaje t'errta" ku burimin e ka revolta. Dhe Migjeni godet kumbueshëm tek poezia "*Kënga e dhimbjes krenare*", "*O këngë e deje*" e dhimbjes krenare, mos pusho kurrë! *Po bashkë me vaje si dy binjak këndonin mjerimin se koha do t'ju bëjëngushllimin*". Kënga e mjerimit kur nxirret nga vetëdija dhemb shumë e pafund po dhembja është krenare ai vuan për të gjithë e me të gjithë panjohuri. Kur po e bëj analizën e këtyre vargjeve më kujtohet kritika aristokratike franceze që ia bëjnëGustavFloburit shkrimtarit të guximshëm freng rreth kryepersonazhit "Ana". Pse aq shumë lot derdh Ana jote në romanin tënd. "*Zonja Bavari*" ai u

përgjigj. *"Ngase kur qanë Ana ime në mes të natës në Paris e për rreth tij qajnë bashkë me të qindra e mijëra vajza me tënjejtin fat"*. Migjeni qante e vuante me të gjithë tëvarfërit shqiptarë përnjëherë por s'epej.

Migjeni veç luftës me klasën sunduese ai luftë bënte edhe me depërtimet dekadente, jo përparimtare me letërsinë e kohës kur jetonte ai. Populli vuante për bukë e ata sillnim filozofinë e të krijuarit ndryshe për turmën jo për shpirtin e turmës por për syrin shqiptar s'ishte ngopur ende bukë e liri Migjeni godet në ciklin e tretë të poezive të tij *"Kënga e Perëndimit"* godet intelektualet e kohës që s'qanin kokën për realitetin shqiptar. *"Kënga e Perëndimit"* këngë e njeriut të dehur nga besimi në vete. *"Le të dëgjojmë këngën qëmshilet nëshllunga avulli në pika djerse"* Çka duhet mbushur zemrën varfanjakve të pafund në Shqipëri veçzemërimitt kumbues të klasës punëtore ajo që qullej në njëdetë djersësh. Migjeni dhëmbë për dhëmbë e gjejmë në grindje me parullat false kapitaliste temë perëndimit dhe fqinjëve tanë për rreth. Ai si jep hapësirë kapitalizmit si ideologji kohe të futet në pretendimet boshe edhe në jetën shqiptare. Jo, jo grindet Migjeni në poezinë "Shpirtin shtegtar" *"Unë ia mbylla derën time me rreze mos të hyjnë. Me ma fikë këtë dritë. Me na ngri këtëshpindë. Me ma dridhe me ndjesitëtjetër Me ma josh me anderrt'vjetër.*

Migjeni nuk do tu ep rast mashtruesve vendas perëndimor t'i futeshin brenda, ai ata i kishte vështruar nga larg *"Si hajn në shtëpitë e kojshivehyjn"*. Ky bënte përpjekje që me vargun e tij t'ia mbyllte derën e të mos i futej edhe kjo e zezë brenda. Të zeza në Shqipëri edhe pa to kemi shumë e pa fund sikur revoltohej Migjeni. Migjeni për moshën e tij ishte shumë i pjekur ai ishte burrëruar para kohe siq shprehet edhe ai në poezinë e analizuar më sipër "Poema e Mjerimit". Çuditërisht Migjeni në këtë moshë të re kur hedh sytë kah gjendja në Shqipëri vështron me ngjyra me të errëta për ata që më së shumti kishin "merita" për këtë gjendje e në tënjëjtën kohë kur hedh sytë kah e ardhmja dhe etja për jetë seç na mahnitë me ngjyra gazi e hareje, me ngjyra qëëmbëlsojnë shpirtin dhe rrisin etjen për jetë dhe dashuri. Këtë e vërejtëm tek poezia "Ekstaza Pranverore" mes poezive tjera. Me këtë poezi gjen ciklin e këngëve të fundit të vëllimit. *"Këngët e rinisë"*, kjo këngëështë stina që Migjeni po e priste kjo është jeta që po e priste kjo është jeta që Migjeni për të po akuzonte e godiste, atë jetë që e dëshironte për të gjithë tërinjtë dhe për vete, edhe sikur kishte një parandjenjë qe ai s'do ta gëzojë. Pranvera erdhi në botë na lajmëron Migjeni për këtë na kishte lajmëruar më parë, po e ndjek

nga dielli alegorik valën. "...dhe Pranvera erdhi erdhi...nëpër fytyrat rrëshqiti një e ndër zemrat tona ngrehi e një jetë e bukur, e një jetë... e me dëshira të shumta pa buzqeshje nëlulzim".¹⁶

Cikli i "Këngëvetë Rinisë"

Migjeni i këndon triumfit të rinisë të së resë dhe jetës. Migjeni s'u ndal kurrë ai qan me lot kur duhet qarë, ai goditi e akuzoi ku duhej goditur e akuzuar, ai dashuroi pa pushuar ku duhej dashuruar, ja si fliste për të dashurit të tij. " Ishte një dashuri e pastër thotë poeti ", ishin dy dëshira të flakta dhe etje për jetë dhe hodhi kristal në embrion, kristal për një vazhdimësi jete. Jetë e fill jete apo çoroditje pa tradhti e pa mashtrime. Kjo ishte ëndrra e çiltër e poetit që s'u bëkurrë realitet. Ja kë kishin gërditur, dashurinëimitimet perëndimore të dashurve mëtradhti e mashtrime. Këtë shqetësim të poetit e vërejmë te poezia "*Mbas tryezës*" ku poeti dënon dashurinë e tërinjve të degjeneruar dhe në Shqipëri ata s'ishin pak, mjerisht ishin shumë. Me këto këngë Migjeni do t'i jap fund krijimtarisë letrare, ku vargut të tij do t'ia jep valën e shtresave të gjera popullore Në një varg të tij nga poezitë të fundit shkruan: "*U vodh... nga zemra e kombit*" Dhe ai ironikisht pyet: Çfarëështë kjo këngë? dhe vetë përgjigjet: është "*Këngë e vajë*" ose më poshtë: " Shprehje e dhimsur e një jetese që dergjet e dergjet. Dhe tu u dergjë do të heshtë e molisun". Këto pyetje e shtegtime të poetit i vërejmë edhe në këngët e fundit të jetës veç po e shihte se po i perëndonte dielli. Këto poezi ai i shkruan diku kah pjesa e parë e vitit 1937.

Ideja e tij po i mbetej e parealizuar fare, pak kohë i duhej e mjerisht edhe ajo pak i mungoi ! Këtë gjë e vërejtëm tek poezia e ditëve të fundit "*Vuajtja*". "*Ka do ditë që po e shoh fare mirë se si nga vuajtja sytë po me madhohen nëpër ballë e fytyrë rrudhat po më shtohen dhe po ndjej se si mëngjezet e mija nuk janë mëmëngjeze kohëvi e punë... as ndërtimi por tështymit dita në ditë e një jete që s'durohet...*"Tani Migjeni veç po e përfundonte këngën e tij këmbanë, një dhimbje të madhe për rrugën e ngelur në shteg pa shpresë për një vazhdim të ri ! "Dhe shpejt do të bahen flamur i vjetruem i rreckun ndër luftat e jetës". Dhe ky dëshpërim personal tek Migjeni bëhet dhe kolektiv as

¹⁶Shuteriqi, Dhimitër, Histori e letërsisë shqipe,1948.

në horizont nuk na jep shpresë për ndonjë rreze në jetën shqiptare ! Njëdëshpërim i tillë tek poeti është i pa ndeshur më parë. Migjeni ishte shpresa e optimizmit, ishte qëndresa. Migjeni mbetet e do mbetet revolucioni, lufta, qëndresa, sakrifica, dhe jeta, jo dëshpërimi. Dëshpërimi në vargun e tij është vetëm momentale, a kohore.

Arti i Migjenit

Poezia e tij jo e tëra i përket romantizmit revolucionar sidomos poezitë " Të birit të shekullit të ri" dhe "Zgjimi" dhe herë realizmit kritik nëpër të cilin zien revolta si skica "*Mollë e ndalume*", "Luli i vocërr" etj. Poezia e tij është diçka veç e veç, herë romantike herë realiste apo të dyja përnjëherë. Stili i tij është i veçantë për kohën, ai është larg nga stilet e kohës në të cilën po krijonte poeti. Stili i tij tepër energjik e tepër sulmues, një stil goditës që nuk njeh mëshirë. Është i tënjëjtës energji qoftë kur godet shtypësit qoftë kur thërret turmën për rezistencë. Stili i tij është pa vëlla as pa motër.

Në poezinë e kohës së tij si ngjan kuj dhe si ngjet kush. Ai ishte stil i veçantë i migjenit. Ja si i drejtohet njerëzve, lexuesve të tij, popullit të tij të dashur:

O vullnete të ndrydhura !

O vullnete të shtrydhura!

Shkundni prangat e mbrapshta !

E me brimëngadhnyese,

me hove viganesh,

deshirashflatruese,

turruni në të gjitha anët.

Dhimbja dhe mjerimi rrin si dy molla binjake kudo në vargun e tij. Nuk do të mbajë me kohë por të bënë ti shtrëngosh grushtet për të fshirë lotët më pastaj...Faza e tij shpesh me poezi na del bukur gjatë e nganjëherë edhe me ton oratorik.

Migjeni, titullin: "*Vargje të lira*" na jep dhe shkrimet e tij duke mos qenë gjithnjë i pajisur me përgatitjen mbi çka kuptojmë me varg të lirë. Ai vargun e lirë me sukses e vendosi tek poezia emblematike "*Zgjimi*" e te ndonjë poezi tjetër, po jo gjithherë e kudo. Strofet dhe vargjet e tij nganjëherë dukshëm binin në sy si të parregullta qoftë nga dyzimi i vargjeve apo edhe rimave. Ai qëllimisht duket se e bashkonte rimën me ato vjersha ku strofat dhe vargjet frymojnë të lirë. Migjeni me vargun e tij ishte i revoltuar në jetë, i revoltuar ishte edhe vargu i tij, sepse ishte jashtë kornizave të zakonshme.

Shpesh herë vargjet e Migjenit në dukje të parë na ngjajnë si të dhuruarae dhe pse janë vargje të rregullta por duhet pasur kujdes leximi i tyre. Ai po aty shton se kjo ngjarje për shkak të zemrës e cila sipas traditës në dialektin gegë, herë lexohet e herë jo! P.sh:

“Thell(ë) nëvehtën time flejn(ë)

Kang(ë)t e pa k(ë)ndueme

T(ë) cilat ende vuajtja as

G(ë)zimi si nxori"

Ai thotë se kujdes duhet pasur në leximin e diftongjeve, të cilat zakonisht Migjeni i eviton, nganjëherë i njeh dy rrokje.

T(ë) cilat flejn(ë) e presin një dit(ë) më t(ë)lumnueme.

Me shperthy e m'ukndue pa frig(ë) e pa zor.

Po të mos theksoheshin të gjitha (ë)të si në shembujt e mësipërm atëherë kemi të bëjmë me katërmbëdhjetë rrokeshin fare të rregullt si veçori e vargut të Migjenit. Diftongjet vetëm në njërin rast të kësaj strofe nuk njihen për dy rrokje te folja e vargut të fundit "kndue".

Gjuha e Migjenit është e folnja e Shkodrës dhe të gjitha tiparet e saj veçmas nga variantet tjera. Migjeni është fanatik gjithherë në të folmen e tij. Në fillet e para të krijimtarisë së tij, has nëvështirësi sa i përket gjuhës ngase ai një kohë të gjatë ishte larguar nga Shkodra e tij e dashur. Por veten e mori shumë shpejtë, kultivoi një gjuhë të pasur të pastër që për kohën ishte në nivel të lartë. Ai me zellin e tij jo vetëm që e mësoi bukur ta flasë e shkruaj variantet e shkodranishtes, por dhe u

veçua si pasurues i këtij varianti. Ja disa disa shembuj nga e folmja e veriut. Fjalët karakteristike të së folmes sa Veriut që e pasurojnë gjuhën e Migjenit”

aht (**rënkim**)

Dihas (**nuhas**)

Dikton (**rrjedh**)

Turravrap (**me nxitim**)

Biban (**gjel deti**)

Poeti krijon edhe ndonjë fjalë të re si: epshore, shterzanë, theqafje.

Ndonjë fjalë e dialektit toskë(**gjiri**)plukasë(**vakët**) etj.

Tek gjuha e Migjenit gjejnë vend edhe disa fjalë të huaja po qëishin bukur risi në atë kohë si:

fontan, delikt, akrobaci, alegori, monoton, fluid etj.

PËRFUNDIM

Poezia e Migjenit

Poezia e Migjenit, një poezi novatore, u bë shprehëse e fuqishme e pakënaqësisë ndaj realitetit, e urrejtjes ndaj dhunës dhe shfrytëzimit, ndaj mashtrimit politik, shoqëror dhe hipokrizisë. Duke shpërthyer drejtpërdrejt nga jeta e gjallë ajo pasqyroi botën shqiptare në vitet '30 me protestat, dhembjet, ëndrrat dhe shpresat për të ardhmen.

Vëllimin e tij "*Vargjet e lira*" (1936) Migjeni e hapte me vjershën "*Parathënia e parathënieve*" ku shpërthente gëzimi i tij se shekulli ka nisur të çlirohet prej skllavërisë shpirtërore. Lajtmotivi i kësaj vjershe e cila është një sintezë e mendimit revolucionar të Migjenit, është vargu: "*Përditë predojnë Zotat*", Njeriu po hipën në majën e fronit, po bëhet zot i jetës, i tokës së tij, i vetvetes dhe nuk do t'u përulet më "idhujve". Pas kësaj vjershat e veta Migjeni i ka ndarë në gjashtë cikle: "*Kangët e ringjalljes*", "*Kangët e mjerimit*", "*Kangët e perëndimit*", "*Kangët më vete*", "*Kangët e rinisë*" dhe "*Kangët e fundit*".

Në ciklin e parë bëjnë pjesë pesë nga vjershat më të mira të Migjenit. Filli që i bashkon këto vepra, është gëzimi për lindjen e "Njeriut të Ri", prej atyre të varfërve të rritur në mjerim, të cilët janë ngritur në luftëra të reja, që të mos humbin më në lojën e përgjaktë të historisë, të mos jenë më skllavër të titajve të tërbuar, por zot të vetes e të një bote të re, ku njeriu të jetë i lirë dhe askush të mos e shkelë personalitetin e tij. Këto luftëra nuk janë grabitqare e as për të siguruar privilegje të reja, si ato të hershmet, por janë luftëra të reja, siç i quan poeti kryengritës. Në këtë cikël kemi edhe protestën ndaj gjendjes së rëndë të shoqërisë shqiptare, ndaj gjithë forcave konservatore, që e mbajnë në vend atë, dhe shpërthimin e entuziazmit për lindjen e "Njeriut", i cili do ta drejtojë kombin drejt një agimi të ri. Në këtë cikël jeton edhe ideja se vetëm në liri mund të shpërthejnë energjitë dhe aftësitë njerëzore. Në gjithë ndryshimet, përmbysjen e botës së vjetër dhe krijimin e botës së re, poeti njih si protagoniste rininë. Ajo është më e pastra, më e bukura pjesë e shoqërisë, ku ai var shpresat, besimin për fitoret e ardhme, për triumfin e idealit për një jetë të re:

Rini, thuejakangës ma të bukur që di!

Thuejakangës sate, që të vlon në gji.

Nxirre gëzimin tand, të shpërthejë me vrull.

Mos e freno kangën! Le të marri udhë.

(Kanga e rinisë)

Përmes kësaj poezie, poeti është i bindur se asgjë s'mund ta pengojë më lulëzimin e lirisë, ku do të shpërthejë hovshëm gjithë ato këngë, që ende i flenë në shpirt. Kjo është intuita e poetit, profecia e tij, i cili ka aftësinë ta ndjejë i pari rrezen e ngrohtë të Diellit të jetës së re:

Por a do të vijë dita kangët me u zgjue

Apo ndoshta shekujt me ne prapë po tallen

Jo, Jo! Se liria filloi me lulzue

Dhe e ndjej nga Dielli (alegorik) valën.

Për identifikimin e figurës Diell ka pasur disa përpjekje për ta zbërthyer e konkretizuar. Por ato vetëm se e kanë vulgarizuar perceptimin poetik të poetit. Mjafton të mbetemi në simbolikën e tij dhe ajo thotë gjithçka. Ai ia ndien rrezatimin botës së re, shoqërisë së re, e cila do të jetë e ngrohtë dhe e ndritshme si dielli dhe si ai do të mund të gjallërojë, të zgjojë të rilindë gjithçka që qëndron ende e ndrojtur, e përgjumur në errësirë. Thirrja që Migjeni i drejtonte rinisë, në këtë vjershë ishte kuptimplotë, optimiste dhe tepër e ngrohtë, intime dhe romantike:

Thueja, kangës, Rini! Thuejakangës gëzimplote!

Qeshu Rini! Qeshu! Bota asht'e jote!

Cikli i dytë i "Vargjeve të lira" nis me "Poemën e mjerimit", kryevepër poetike e Migjenit dhe një prej krijimeve më të bukur të poezisë shqiptare. Poema ka një konceptim e

trajtim origjinal. Në fillim poeti sjell figurën e mjerimit të konkretizuar nëpër dhjetëra motive jetësore. Dhe së bashku me fytyrën tragjike të mjerimit në jetën shqiptare, vjen edhe dhembja, dhembja e poetit dhe dhembja që mbyl çdo shoqëri të ngritur mbi dhunën. Kjo dhembje e thellë përfundon në protestën ndaj rendit shoqëror që e krijon mjerimin, dhe në ironi dhe sarkazëm ndaj fesë, e cila s'arrit ta ndryshojë këtë pamje tragjike, megjithë lutjet e mëshirat mijëvjeçare. Pas kësaj poeti konkludon:

Mjerimi s'do mëshirë, por don vetëm të drejtë!

I gjithë cikli pavarësisht nga dhembja e thellë dhe pamja tragjike që krijohet ka tone optimiste, sepse nuk kemi të bëjmë me një dhembje mbytëse, por me dhembje krenare, të cilat sipas poetit, koha do të dijë t'i qetësojë. Në këtë cikël poeti na jep për herë të parë me shumë art figurën e punëtorit që shfrytëzohet kafshërisht ose endet i papunë, duke thelluar kështu pamjen tragjike të mjerimit.

Gjithashtu në këtë cikël ai trajton edhe temën deri diku antifetare ku demaskon institucionet fetare, si bashkëfajtores të asaj shoqërie që pjell mjerimin. Në ciklin e tretë "*Kangët e prendimit*", Migjeni, sjell pamjen e Evropës para Luftës së Dytë Botërore, ku plagët e tmerrshme shoqërore dhe krizën ekonomike përpiqen t'i mbulojnë me pseudoart, me vepra e filma sentimentale që e vishnin me ngjyra artificiale lumturie dramën shoqërore e politike. Po përtej kësaj cipe të neveritshme poeti sheh botën e rëndë të shtëllungave të tymit e të avujve, të djersës e gjakut. Në të dy vjershat e këtij cikli poeti sjell imazhin e një bote sonambul që po rrëshqet drejt greminës së shkatërrimit, drejt luftës. Kjo botë e zhytur në mjergull ende s'po e kupton se po i përgatisin një tragjedi të re. Për t'u orientuar në këtë botë të dehur, poeti kthehet nga bota punëtore e uzinave me thirrjen poetike:

Le të dëgjojmë kangën që mshtillet në shllung

Avull, në pika djerse,

Si vazhdim i këtij mendimi poetik, autori duke dashur që vëllimi i tij të ketë një kompozicion kuptimplotë, vendos vjershën "*Kangë më vete*" ku ai sjell më konkret imazhin e luftës së ardhme me shkaktarin e vërtetë të saj, fashizmin, që po hyn si hajn edhe në Ballkan. Menjëherë pas kësaj vjen cikli "*Kangët e Rinisë*", që së bashku me ciklin "*Kangët e fundit*" janë

më intime, më shprehës të shpirtit të poetit, të vuajtjeve, dëshirave, pasioneve të tij. Te "*Kangët e rinisë*" bën pjesë vjersha "Ekstazë pranverore", që së bashku me këngët e ringjalljes dhe "Sonet Pranveror", janë krijimet më pasionante, më optimiste e më me ndjenjë të poezisë migjeniane. Aty ndihet thellë himni i triumfet të një bote të re, që do të jetë gjallëruese si një pranverë. A do të arrijë poeti t'a shijojë këtë pranverë? Parandjenja e një vdekjeje që po i afrohet, i jep dhembje poetit që, ndoshta, s'ka për ta parë këtë botë të re. Por gëzimi i triumfit të saj është kaq i madh sa dhembja vjen në përmasa reale e jo në trajtën e pesimizmit. Te këto dy cikle jeton edhe dashuria e poetit, e cila sjell imazhin e bukur të një dashurie rinore, ku është shkrirë pasioni për vajzën, dëshira për të shijuar gjithçka të bukur, si dhe dashuria për krijimin e jetën në përgjithësi.

Në tetë vjershat e fundit, që i janë shtuar vëllimit më vonë ndihet edhe trishtimi, dhembja dhe pesimizmi i poetit, që e sheh se si po i fiket pak nga pak jeta. Por ato nuk e rëndojnë gjendjen shpirtërore të lexuesit, sepse janë të natyrshme dhe njerëzore. Në disa vjersha "*Rezinata*", "*Trajtat e mbinjeriut*" etj. Migjeni trajton motive filozofike rreth kuptimit të ekzistencës së njeriut, të jetës, të vetëflijimit për të ardhmen e shoqërisë, të botës etj. Trajtimi i këtyre ideve është pak i mjegulluar, sidomos kur poeti sjell edhe mbinjeriun, që mendohet se është nocion që ka evoluar, në krahasim me kuptimin që i pati dhënë krijuesi i tij Niçja. Mbinjeriu i Migjenit, nuk është përbuzësi i vegjëlisë. Ai është një figurë, që merr përsipër të udhëheqë masat drejt një bote të re, ku të ketë kuptimin e vërtetë edhe sakrificimi edhe ekzistenca, edhe dashuria, pra, të marrë një kuptim të ri jeta. Mendimi në këto vjersha vjen i turbullt dhe lë shteg për t'u interpretuar në mënyra të ndryshme, por ato kanë diçka të përbashkët, optimizmin, dashurinë për njeriun, dashurinë për të renë, për të bukurën.

Migjeni veprimtarinë e tij letrare në të dy fushat: frazë dhe poezi e filloi në një kohë të pakohë, në një kohë të vështirë skajshmërisht. Migjeni u gjet përballë kësaj gjendjeje, ose të heshtë para këtij realiteti të hidhur ose të reagonte ashtu si dhe bëri. U ndesh ballë për ballë me këtë shëmti kohë dhe i shtrëngoi grushtet e rezistencës e kundërshtimet. U shndërrua në një kabanë që kumbonte herë një zgjim deri në një fitore. Një fitore për atë klasë skamnorësh anë kënd Shqipërisë. Si askush në atë kohë vuajtjesh e trishtimesh për kombin ai u vu në ballë të turmave me vargun e tij kryengritës ai nuk kërkonte mëshirë por veç të drejtë. Ai nuk shkroi nga zyra e ngrohtë, ai shkroi kudo e kurdo kur i piku vargu si pikë loti nga dhimbja. Ai vrapoi pas lypsit, ku jeton dhe

pse shtrin dorën sepse e dinte se s'ishte në gjenin e këtij me shtri dorën. Ai në një vend deklarohet hapur: Po unë vuaj e do të vuaj me fëmijën që babai nuk ia blenë lodrën, Do të vuaj me bujkun që s'ka një pllug që do ta vente një hulli për arë e farë... Po vuaj e do të vuaj me plakun që pranë oxhakut dridhet nga ethet e vdekjes. Po vuaj e po vuaj me ririnë që digjet në flakën e dashurisë dhe Po vuaj e do të vuaj me të sëmurët e sëmundjet e botës përnjëherë. Ishte ky Migjeni i shpresës dhe i revoltës, i dëshpërimit dhe i gëzimit të jetës.

Ishte ky Migjeni ynë i mjerimit që vdiq herët se do të na linte vepra madhore. Ishte ky Migjeni i poezive, skicave, tregimeve, novelave ku trajtoheshin fëmijët, të rinjtë, të rejtat, nënat e pafat me shpresa të thyera. Ishin nënat si nuk ishin dikur dhe si duhej mbetur se të tilla. Migjeni i krenarisë dhe dhembjesh kombëtare, Migjeni uragan kohe, Migjeni mbjellës i një fare të re në një hullie të re. Ishte ylli i mëngjesit, ishte kënga që su ndal kurr ndër breza. Ishte Migjeni ai pisha e ndezur me flakë si flakadan kushtrimi nëpër kohërat shqiptare. Ishte Migjeni ajo dhimbja jonë e madhe gjithëkombëtare.

AUTOBIOGRAFIA

Unë quhem Dukagjin Geca, u linda më 01.02.1995

Shkollën e mesme të ulët e përfundova në shkollën “Trepça” në Banjë të Pejës.

Shkollën e mesme të lartë e përfundova në shkollën e mesme të mjekësisë “RamizSadiku” në Pejë.

Pastaj vazhdova studimet në Universitetin e Gjakovës “FehmiAgani”, në Fakultetin e Filologjisë – Dega Letërsi Shqipe.

LITERATURA

1. Migjeni, “Vargje të lira”, 1936.
2. Stefi, Andrea, ”Rreth historisë së besimit të vëllimit”, Tiranë, 1995
3. Migjeni, “Parathënie e parathënieve”, Prishtinë, 1977.
4. Shuteriqi, Dhimitër, “Histori e letërsisë shqipe”, fq.34.
5. Qosja, Rexhep, “Migjeni dhe poezia e tij”, Dialogje me shkrimtarë, Prishtinë.
6. Mark Gurakuqi, “Rreth kritikës mbi veprën e Migjenit”, Tiranë, 1961.
7. Ismail Kadare, “Uragani i ndërprerë: Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe”, Onufri, Tiranë 2009.
8. Rexhep Qosja, “Dialogje me shkrimtarë”, Rilindja, Prishtinë 1979.
9. Migjeni, Vepra 2 (PROZË), Rilindja, Prishtinë 1980.
10. Vehbi Bala – MusaKraja, Migjeni Portret Monografi, Rilindja, Prishtinë 1980
11. Migjeni, Vepra 4 (KRITIKË), Rilindja, Prishtinë 1980.
12. PetroJanura, Migjeni, Flaka e vëllazërimit (OBPB), Shkup 1982.
13. SkenderLuarasi, Migjeni Vepra, Tiranë, 1957.
14. Migjeni, “Vargjet e lira dhe Novelat e qytetit të veriu”, Tiranë 2009.
15. Sabri Hamiti, “Studime letrare”, Prishtinë 2003.

Burime nga interneti

<https://sq.wikipedia.org/wiki/Migjeni>

<http://www.12vite.com/vargjet-e-lira-migjeni/>

¹<http://www.bulevardionline.com/millosh-gjergj-nikolla-migjeni/>

